



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.36.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AGJENCISË PËR NDIHMË
JURIDIKE FALAS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik dhe praktikatat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në konsultim me Asistent Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Valbon Bytyqi, i mbështetur nga, Shehrije Shala-Aliu (Udhëheqës Ekipi), Ajtene Llapashtica (Anëtare e ekipit).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	9
4 Qeverisja	10
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	19
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	22


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Kryesuesin e Këshillit dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 09/12/2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Opinion i pamodifikuar


Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (**SNISAI 200/1700 Opinion i Pamodifikuar**).

Konkluzioni i përgjithshëm

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ka zbatuar kontrole të brendshme efektive për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet dhe ne kemi marrë siguri nga këto për shumicën e fushave në kuadër të Pasqyrave Vjetore Financiare.

Buxheti është realizuar në pajtueshmëri të plotë me planin e rrjedhjes së parasë. Kontrole efektive vërehen edhe të menaxhimi i obligimeve dhe menaxhimi i pasurisë ku ekzistojnë evidenca të mjaftueshme për saktësinë dhe prezantimin e tyre.

Megjithëse, ndarja e detyrave dhe përgjegjësiive ende nuk ishte në nivelin e duhur. Konkluzioni dhe rekomandimi ynë kryesorë është:



Përgjigja e Menaxhmentit - auditimi 2014

Të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport janë marrë në konsideratë nga Menaxhmenti.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien në mënyrë efikase të produkteve operative cilësore. Për sistemet individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin funksionojnë kontrollet aktuale. Shembull i një aktiviteti mund të jetë monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operative. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Për këtë nevojitet një vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetme ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësisë së informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

ANJF ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të ishin të përgatitura në pajtim me kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullores MF - Nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale (**SNISAI 200/1700 Opinion i Pamodifikuar**).

2.2 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

PVF-të e ANJF-së, përfshirë edhe të gjitha kërkesat tjera për raportim duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 dhe ndryshim plotësimet e tij;
- Pajtueshmërinë me Rregullën MF - nr. 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore;
- Kërkesat e rregullores nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike;
- Kërkesat e rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare të organizatave buxhetore;

- Kërkesat nga rregulla financiare nr.02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore; dhe
- Kërkesat e procedurave të Menaxhimit të Kontrolleve Financiare (MKF).

Lidhur më kërkesat e lartcekura ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit, të datës 09 dhjetor 2014, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

ANJF ka adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna në raportin e auditimit për vitin 2013. Ne e inkurajojmë menaxhmentin që të merr masat dhe veprimet e duhura për të adresuar edhe rekomandimet e këtij viti.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e ANJF-së për vitin 2013, ka rezultuar me tri rekomandime kryesore. ANJF kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, ANJF ka arritur të adresoj plotësisht të gjitha rekomandimet. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Qeverisja

Konkluzioni i përgjithshëm

Aspektet kyçe të kornizës së qeverisjes janë adresuar nga ANJF si në vazhdim:

- Vetëvlerësimi – Raporti i vetëvlerësimit është bërë në përputhje me rregullat MFK-së, është dorëzuar me kohë në të cilën janë paraqitur komponentët e caktuara të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
- Menaxhimi i rrezikut – ANJF nuk ka aprovuar/aplikuar ndonjë procedurë formale për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve operationale në nivel të organizatës. Mirëpo ata kanë bërë një vlerësim të rreziqeve përmes raportit vjetor dhe planit strategjik; dhe
- Raportimi i menaxhimentit – në baza të rregullta në të cilat është diskutuar në detaje menaxhimi i buxhetit dhe çështje tjera rreth aktiviteteve operative.

ANJF ka zbatuar kontrole të brendshme efektive për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet dhe ne kemi marrë siguri nga këto për shumicën e fushave në kuadër të PVF-ve.

Buxheti është realizuar në pajtueshmëri të plotë me planin e rrjedhjes së parasë. Kontrole efektive vërehen edhe të menaxhimi i obligimeve dhe menaxhimi i pasurisë ku ekzistojnë evidenca të mjaftueshme për saktësinë dhe prezantimin e tyre.

Megjithëse, ndarja e detyrave dhe përgjegjësive ende nuk ishte në nivelin e duhur. Drejtori i Administratës Qendrore kryen edhe funksionin e Zyrtarit Kryesor Financiar. Kjo mund të shkaktoj konflikte interesi. Ndërsa, nga aspekti i rëndësisë me të ulët monitorimi i kontroleve nevojitet edhe në menaxhimin e proceseve të prokurimit.

4.1 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për ANJF-së dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Burimet e Fondeve:	303,211	396,294	297,728	289,564	284,263
Granti i Qeverisë -Buxheti	303,211	285,483	284,128	282,609	284,263
Donacionet e jashtme ²	-	110,811	13,600	6,955	-

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 93,083€. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i implementimit të vendimeve të Qeverisë si dhe donacioneve.

Në vitin 2014, ANJF ka shpenzuar 75% të buxhet final, ose 18% më pak krahasuar me vitin 2013 (në vitin 2013 është shpenzuar 93% e buxhetit). Deri në muajin dhjetor të vitit 2014 buxheti ishte duke u shpenzuar sipas planit të rrjedhjes së parasë. Megjithatë pranimi i donacionit nga Qeveria Norvegjeze në vlerë 97,137€ në muajin dhjetor 2014 ka rritur buxhetin final për 32%. Si rezultat një pjesë e buxhetit (pjesa e donacionit) nuk ka arritur të realizohet gjatë vitit 2014.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	303,211	396,294	297,728	289,564	284,264
Pagat dhe Mëditjet	138,266	211,186	145,279	123,782	122,585
Mallrat dhe Shërbimet	150,925	163,315	139,930	153,824	148,608
Shërbimet komunale	14,020	21,793	12,519	11,958	13,071

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje në vlerë për 72,920€ ishte si rezultat i implementimit të vendimit të Qeverisë³, si dhe pranimit të donacionit në vlerë prej 65,906€. Dallimi në

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave.

² Vlera prej 13,674€ është donacion i projekt të UNDP-së (Avancimi i drejtësisë gjinore), për pagesat e përfaqësimit dhe avokaturës, të bartura nga viti 2013.

³ Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/176, i datës 10.03.2014 për rritjen e pagave 25%.

mes të buxhetit final dhe shpenzimeve në vlerë 65,906€ është pikërisht vlera e donacionit e cila ishte e dedikuar të shpenzohet në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015;

- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur për 12,390€. Fillimisht me vendimin e Qeverisë⁴ së Republikës së Kosovës buxheti ishte reduktuar për 21,750€, si dhe 1,500€ si rezultat i transferimit të buxhetit në komunal, mirëpo, më pas, ishte rritur si rezultat i pranimet të donacioneve për 35,640€;
- Te komunalitë buxheti fillimisht ishte reduktuar si rezultat i vendimit të Qeverisë për shkurtime buxhetore për 3,000€, mirëpo më pas ishte rritur si rezultat i pranimet të donacionit për 9,273€ dhe transfereve nga mallrat dhe shërbimet për 1,500€.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të raportuar lidhur me planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2 Të hyrat (donacionet e jashtme)

Përshkrimi

Buxheti total i donacioneve për vitin 2014 ishte 110,810€ (13,674€ janë mjete të bartura prej vitit të kaluar nga donacioni UNDP⁵, ndërsa në muajin dhjetor 2014 ishin pranuar donacion në vlera për 97,137€ nga Qeveria Norvegjeze⁶).

Nga projekti i UNDP-së ishin shpenzuar 13,600€, ndërsa mjetet nga projekti i Qeverisë Norvegjeze janë bartur për vitin 2015 sipas marrëveshjes për mbështetjen e aktiviteteve.

Qëllimi i dhënies së donacioneve ishin pagesat e përfaqësimit të avokatëve në avancimin e drejtësisë gjinore si dhe qasje e barabartë në drejtësi. Aktualisht ofrimi i ndihmës juridike falas shtrihet në pesë regjione të Republikës së Kosovës, përmes pesë zyrave regjionale: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan.

Pranimet nga donacionet e jashtme janë menaxhuar dhe raportuar në pajtim me marrëveshjet e përcaktuara.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

⁴ Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.07/172, i datës 27.02.2014 për kursimin e shpenzimeve prej 15% të buxhetit.

⁵ Projekt të UNDP (Avancimi i drejtësisë gjinore) për pagesat e përfaqësimit dhe avokaturës të bartur nga viti 2013.

⁶ Projekti nga Qeveria (Ambasada) Norvegjeze për "Qasjen e Barabartë në Drejtësi".

4.3 Shpenzimet

4.3.1 Prokurimi

Përshkrimi

Rregullat e prokurimit kanë për qëllim të sigurojnë se fondet publike arrijnë vlerën për para përmes aplikimit transparent dhe efikas të tyre. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në prokurimin publik.

Ne kemi rishikuar procesin e blerjeve përmes prokurimit për të vlerësuar nëse ANJF-së ka zbatuar procedurat dhe i është përmbajtur dispozitave të ligjit të prokurimit publik. Ekzaminimet tona kanë përfshirë tërë procesin e prokurimit, duke filluar nga iniciimi i aktiviteteve të prokurimit e deri të menaxhimi dhe realizimi i kontratave.

ANJF, gjatë vitit 2014 kishte nënshkruar 15 kontrata (nëntë më kuotim të çmimeve dhe gjashtë më vlerë minimale) përmes procedurave të prokurimit me vlerë të përafërt të realizimit 27,709€. Mostra jonë ka përfshirë tetë kontrata në vlerë prej 13,898€ si dhe shtatë pagesa tjera në vlerë 3,721€, për të rishikuar nëse të gjitha blerjet janë bërë në pajtueshmëri me kërkesat e legjislacionit.

Në raport më vitin e kaluar kontrollet në procesin e prokurimit janë përmirësuar dukshëm. përjashtim edhe më tutje bëjnë disa parregullsi të cilat i kemi prezantuar në vijim:

Çështja 1 - Autoriteti Kontraktues nuk i kishte bërë kërkesë me shkrim tenderuesit për të marrë siguri për çmimet jo normalisht të ulëta - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas LPP, neni 61 “nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim: (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit.
- Te lëndët “Servisimi - Mirëmbajtja dhe Riparimi i Automjeteve të ANJF-së”, si dhe “Furnizim, Servisim dhe Mirëmbajtje e IT” disa Operator Ekonomik (OE) në ofertat e tyre kishin ofruar çmime jo normalisht të ulëta.
- ANJF kishte lidhur kontratë më të njëjtit OE, edhe përkundër faktit se nuk ju kishte drejtuar kërkesa me shkrim tenderuesit për të marrë siguri lidhur me çmimet e ofruara.
- Ne testuam disa pagesa për të verifikuar rregullsinë e tyre dhe verifikuam se çmimet e ofruara nga operatorët ekonomik ishin në pajtim me kontratën.
- Rreziku** Lidhja e kontratës me OE që ofertojnë me çmime më të ulëta se ato të tregut vë në rrezik implementimin e kontratës dhe përmbushjes së nevojave të autoritetit kontraktues.
- Rekomandimi 1** Kryesuesi i Këshillit në bashkëpunim me Drejtorin Ekzekutiv duhet të siguroj se komisionet e vlerësimit të ofertave analizojnë mjaftueshëm ofertat, dhe në rastet e konstatimit se çmimet janë jo normalisht të ulëta të dërgojnë kërkesa të të njëjtit për të marrë siguri se ata do të ofrojnë të gjitha produktet dhe shërbimet në pajtueshmëri me ofertën e dorëzuar.

Çështja 2 - Procesimi i urdhërblërjes pas pranimit të faturës - Prioritet i mesëm

E gjetura Në pesë pagesa në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve kemi hasur në urdhërblërje të cilat janë proceduar pas pranimit të faturës. Këto i kemi paraqitur në vijim:

- Te pagesa lidhur me kontratën, "Mirëmbajtja dhe servisimi i auto veturave për nevojat e ANJF-së", fatura në vlerë 774€ ishte pranuar me datë 02 mars 2014, ndërsa urdhër blerja ishte lëshuar me datë 03 qershor 2014, pas tre muajve;
- Te pagesa lidhur me kontratën, "Mirëmbajtja dhe servisimi i auto veturave për nevojat e ANJF-së", fatura në vlerë 695€ ishte pranuar me datë 04 korrik 2014, ndërsa urdhër blerja ishte lëshuar me datë 09 korrik 2014, pas pesë ditëve;
- Te pagesa lidhur me kontratën, "Mirëmbajtja dhe servisimi i auto veturave për nevojat e ANJF-së", fatura në vlerë 780€ ishte pranuar me datë 03 shkurt 2014, ndërsa urdhër blerja ishte lëshuar me datë 05 shkurt 2014, pas dy ditëve;
- Te pagesa lidhur me kontratën, "Mirëmbajtja dhe riparimi i automjetit Fiat Ducato", fatura në vlerë 120€ ishte bërë me datë 27 shkurt 2014, ndërsa urdhër blerja ishte lëshuar me datë 03 mars 2014, pas katër ditëve; dhe
- Te pagesa lidhur me kontratën, "Servisimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë informative", fatura në vlerë 900€ ishte bërë me datë 06 janar 2014, ndërsa urdhër blerja ishte lëshuar me datë 05 shkurt 2014, pas 30 ditëve.

Vlen të ceket se gjatë tre mujorit të fundit, ANJF ka shtuar kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave. Brenda kësaj periudhe ne nuk kemi vërejtur në asnjë rast të procedimit të urdhërblërjeve pas pranimit të faturës.

Rreziku Kryerja e pagesave për mallra dhe shërbime para se të përcaktohen kërkesat/nevojat, mund të rezultojë që të pranohen mallra të cilësisë dhe sasisë jo të nevojshme.

Rekomandimi 2 Kryesuesi i Këshillit në bashkëpunim me Drejtorin Ekzekutiv duhet të sigurojnë se kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPF-në, dhe me rregullat e Thesarit.

4.3.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrimi

Në kategorinë e shpenzimeve tjera për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit ne kemi testuar 13 pagesa në vlerë 12,639€, të cilat kishin të bënin me shpenzimet për udhëtime jashtë vendit, shpenzimet për pagesat e përfaqësimit të avokatëve si dhe shpenzimet e qirasë.

Gjatë testimit të tyre nuk kemi hasur në ndonjë mangësi për tu raportuar.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.3.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP).

Gjatë auditimit ne kemi rishikuar listat e pagave si dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PVF. Po ashtu kemi testuar disa mostra, përfshirë dosjet e personelit dhe procedurat e rekrutimit, pajtueshmërinë e pagesave të pagave në raport me kontratat e punës përfshirë edhe bazën e koeficienteve, përcaktimin e lartësisë së pagesave për mëditjet e këshillit si dhe mirëmbajtjen e dosjeve të personelit.

Bazuar në këtë, konstatojmë se ANJF kishte menaxhuar pagat në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin në fuqi. Përfundim nga kjo bënë rasti lidhur me ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi.

Çështja 3 - Ndarje jo e duhur e detyrave dhe përgjegjësi - Prioritet i lartë

- E gjetura** Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi nuk është në nivelin e duhur. Drejtori i Administratës Qendrore qysh prej vitit 2011 kryen edhe funksionin e Zyrtarit Kryesor Financiar (që nga 09 tetor 2014, kryerja e këtyre funksioneve është mbuluar edhe më vendim të Drejtorit Ekzekutiv).
- Rreziku** Mos ndarja e detyrave dhe përgjegjësi në nivelin e duhur, reflekton mungesën e kontroleve dhe dobëson aspektin e llogaridhënies.
- Rekomandimi 3** Kryesuesi i Këshillit në bashkëpunim me Drejtorin Ekzekutiv të rishikoj mundësinë e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi në mes të Drejtorit të Administratës dhe Zyrtarit Kryesor Financiar, në mënyrë që të mos krijohet mundësi për konflikte të mundshme interesi.

4.4 Pasuritë dhe detyrimet

4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrimi

Menaxhimi i pasurisë kapitale është pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Objektivat në lidhje me trajtimin e pasurisë kanë të bëjnë me sigurimin dhe menaxhimin efektiv të pasurisë, si dhe mbajtjen e saktë dhe të plotë të regjistrave të pasurisë, përmes përditësimit të vazhdueshëm të të dhënave.

Pasuria kapitale e regjistruar në regjistrin kontabël ishte 36,708€, ndërsa pasuria jo-kapitale me vlerë nën 1,000€ ishte 11,350€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore. Gjithashtu, ne kemi bërë ekzaminim fizik të pasurisë së evidentuar në regjistrat e pasurisë.

ANJF, kishte menaxhuar pasuritë e veta në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrimi

Pasqyra e obligimeve të ANJF-së në fund të vitit 2014 ishte në vlerë 2,424€. Të gjitha obligimet e mbetura ishin ndaj faturave të cilat janë pranuar pas mbylljes së afatit ligjor për pagesë.

Ne kemi testuar mënyrën e raportimit të tyre dhe kemi bërë teste substanciale për të rishikuar nëse obligimet e mbetura në fund të vitit 2014 janë paguar në fillim të vitit 2015.

Ne nuk kemi hasur me ndonjë parregullsi gjatë menaxhimit dhe raportimit të tyre.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Në bazë të kërkesave të udhëzimit administrativ nr. 23/2009, për themelimin dhe funksionimin e Njësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik, ANJF nuk i plotëson kriteret për të themeluar këtë njësi.

Meqenëse, ANJF është institucion me buxhet të vogël auditimet e brendshme nuk bëhen për çdo vit. Auditimi i fundit ishte bërë në fund të vitit 2011 nga NJAB në kuadër të Ministrisë së Financave dhe ka përfshirë menaxhimin e shpenzimeve si dhe dosjet e personelit.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
4.3.1. Prokurimi	Kryesuesi i Këshillit duhet të sigurojë nivel më të lartë të konkurrencës gjatë zhvillimit të procedurave më kuotime të çmimeve. Në këtë aspekt të dërgohet kërkesa me shkrim OE që ftohen të marrin pjesë.	Po		
4.3.1. Prokurimi	Kryesuesi i Këshillit duhet të sigurojë se ekziston një proces i vazhdueshëm i informimit për OE-të e pasuksesshëm.	Po		
4.3.1. Prokurimi	Kryesuesi i Këshillit duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet në procesin e pranimit të mallrave dhe shërbimeve, duke formuar komisione për pranimin e tyre.	Po		